

Emisionet e radios dhe oferta e internetit e Deutsche Welle-s

Deutsche Welle (Dojçe Vele) ofron shumë mundësi për të mësuar gjermanisht. Në webfaqen gjeni kurse falas të gjermanishtes për fillestarë dhe të avancuar në gati 30 gjuhë. Atje gjenden edhe listat e frekuencave të emisioneve të radios jashtë Gjermanisë.

Mund të shfrytëzoni p. sh. edhe kursin audio të gjuhës "Radio D" të zhvilluar nga Deutsche Welle bashkë me Institutin Goethe. Fillestarët pa njohuri të mëparshme ose me njohuri të paktë mund t'i shkarkojnë seritë audio nga Radio D ose t'i abonojnë si "podcast". Përveç kësaj, kursi transmetohet në 16 gjuhë nëpër DW Radio. Veç kësaj, një kurs i ri interaktiv online i gjuhës paraqet në 30 mësimet me mbi 1000 ushtrime interaktive një imazh të jetës në Gjermani. Në hapat e parë në gjermanisht mund të ndihmojë edhe romani policor "Misioni Berlin".

Në qoftë se ju pëlqen të mësoni rrugës, Deutsche Welle ju ofron edhe një guidë gjuhësore mobile, p. sh. për celularët. Përfshin mësimet të vogla me ushtrime interaktive për t'u shkarkuar. Një fjalor me fjalë dhe shprehje ju ndihmon gjatë orientimit të parë në Gjermani.

Material mësimor në letër

dhe material multimedial mund ta blini edhe në Gjermani. Lista me literaturë dhe adresa në të cilat mund të blini material mësimor i gjeni nëpërmjet webfaqes ose numrit të telefonit të Entit Federal për Migrim dhe Refugjatë.

Bashkëbisedues që ju ndihmojnë

Informacione për gjendjen ligjore dhe për mundësitë për të mësuar gjermanisht i gjeni në webfaqen e Entit Federal për Migrim dhe Refugjatë dhe në **numrin e tij të telefonit +49 911 - 943 6390**.

Në webfaqen www.integration-in-deutschland.de vihen në dispozicion edhe linqe interneti për adresat vijuese të internetit si dhe informacione të mëtejshme:

- Informacione më të hollësishme për kompetencat gjuhësore në nivelin A1 i ofron Korniza e përbashkët europiane e referimit për gjuhë:
 - <http://www.goethe.de/ger>
- Për provimin e njohurisë së gjuhës në ribashkimin e bashkëshortëve furnizuesit e njohur botërisht dhe partnerët të provimit:
 - <http://www.goethe.de/pruefungenweltweit>
 - <http://www.telc.net>
 - <http://www.testdaf.de>
- Informacione dhe oferta për mësim gjuhe të Institutit Goethe:
 - <http://www.goethe.de/fernunterricht>
 - <http://www.goethe.de/lernen>
 - <http://www.goethe.de/sdl> (provimi-model i certifikatës Goethe A1 "Starti i gjermanishtes")
- Informacione dhe oferta për mësim gjuhe të Deutsche Welle-s:
 - <http://www.dw-world.de/deutschkurse>
 - <http://www.dw-world.de/radioD> (kursi audio i gjuhës "Radio D")
 - <http://www.dw-world.de/deutschinteraktiv> (kursi interaktiv online i gjuhës)
 - <http://www.dw-world.de/missionseurope> (romani policor për mësim gjuhe)
 - <http://mobile.dw-world.de> (guida mobile e gjuhës)
- Portali i integritimit i Entit Federal për Migrim dhe Refugjatë:
 - <http://www.integration-in-deutschland.de>
- Informacione të përfaqësive të jashtme të Gjermanisë:
 - <http://www.auswaertiges-amt.de/diplo/de/Laenderinformationen/03-WebseitenAV/Uebersicht.html>

Dëftues botimi

Botoi:
Bundesamt für Migration und Flüchtlinge
Abteilung 3 Integration
Referat Öffentlichkeitsarbeit Integration
90343 Nürnberg

Përgjegjëse: Erwin Schindler
E-Mail: info.buerger@bamf.bund.de
Internet: www.integration-in-deutschland.de

Redaksia: Referat Konzeption, pädagogische Grundsatzfragen der Integrationskurse
Gjendje: Korrik 2009
Shtyp: Bonifatius GmbH, Druck-Buch-Verlag, Paderborn
Rishikimi: KonzeptQuartier® GmbH
Dëshmia e fotografive/ilustrimeve: Marion Vogel, Corbis GmbH



Bundesamt
für Migration
und Flüchtlinge

Dëshmia e njohurive të thjeshta të gjermanishtes në rast bashkimi me bashkëshortët nga jashtë

Gjermania ka ndryshuar ligjin për të huajt

Informacione për bashkëshortët që ndiqen pas, dhe për bashkëshortët e tyre që jetojnë tashmë në Gjermani



www.integration-in-deutschland.de

Çfarë ka ndryshuar për ju?

A dëshironi të transferoheni te bashkëshorti juaj në Gjermani?

Apo a dëshironi të transferoheni bashkë me bashkëshortin tuaj për në Gjermani?

Apo a dëshironi të vini në Gjermani për t'u martuar dhe për të jetuar atje me bashkëshortin tuaj?

Po. Në përgjithësi nuk keni nevojë të dëshmoni njohuri të gjermanishtes nëse, mes tje-rash, njëri prej pohimeve vijuese është i vërtetë¹:

A ka përjashtime?

Po. Normalisht ju nuk duhet të dëshmoni njohuri të gjermanishtes, nëse ndër të tjerat një prej pohimeve të mëposhtme është i vërtetë:

- Ju ose bashkëshorti juaj jeni shtetas i një shteti anëtar të Bashkimit Europian (me përjashtim të Gjermanisë).
- Për shkak të një sëmundjeje ose një hendikepi fizik(e), mendor(e) ose psikik(e) nuk jeni në gjendje për të dëshmuar njohuri të thjeshta të gjuhës gjermane.
- Ju keni një diplomë të një shkolle të lartë dhe për shkak të njohurive tuaja gjuhësore parashikohet që në Gjermani mund të gjeni një vend pune (nevojë dukshëm e ulët për integrim)
- Nuk dëshironi një qëndrim të përhershëm në Gjermani.
- Bashkëshorti juaj ka një lejeqëndrim si
 - njeri me kualifikim të lartë (§ 19 Ligji për qëndrim).
 - kërkues (§ 20 Ligji për qëndrim).
 - themelues firme (§ 21 Ligji për qëndrim).
 - i autorizuar për azil (§ 25 kryerr. 1 përkat. § 26 kryerr. 3 Ligji për qëndrim)
 - refugjat i pranuar (§ 25 kryerr. 2 përkat. § 26 kryerr. 3 Ligji për qëndrim).
 - i autorizuar për qëndrim afatgjatë nga shtete të tjera të BE-së (§ 38a Ligji për qëndrim).
- Bashkëshorti juaj është shtetas i Australisë, Izraelit, Japonisë, Kanadasë, Republikës së Koreas, Zelandës së Re ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për hollësi të mëtejshme kontaktoni, ju lutem, organet përkatëse për lëshim vizash.



Cilat janë njohuri të thjeshta të gjermanishtes?

Njohuri të thjeshta të gjermanishtes janë njohuri të gjuhës gjermane në "Shkallën e kompetencës A1 të Kornizës së përbashkët europiane të referimit për gjuhë"². Kësaj i përket që mund të kuptoni dhe të përdorni shprehje të përditshme familjare dhe fjali shumë të thjeshta (p. sh. të pyesni për rrugën, të bëni pazar etj.) Duhet të jeni në gjendje ta prezantoni veten dhe të tjerë, të bëni pyetje dhe t'u përgjigjeni pyetjeve rreth vetes suaj, p. sh. ku banoni ose cilët njerëz i njihni. Natyrisht bashkëbiseduesit tuaj duhet të flasin qart dhe të jenë të gatshëm për të ndihmuar.

Edhe duhet të jeni në gjendje të shkruani tashmë diçka në gjermanisht, p. sh. mund të shkruani emrin, adresën, kombësinë etj. në formularë nga autoritetet.

Si mund të dëshmoni njohuri të thjeshta të gjermanishtes?

Zakonisht njohurit e gjuhës duhet t'i dëshmoni para hyrjes në Gjermani gjatë kërkimit të vizës për bashkimin bashkëshortor në ambasadën gjermane përkatësisht në konsullatën e përgjithshme.

Duhet që në dokumentet e aplikimit të keni të përfshirë edhe një certifikatë të gjuhës, nga një provim i gjuhës i standardizuar në përputhshmëri me standardet e Association of Language Testers in Europe (ALTE). Kjo është aktualisht në dispozicion për certifikatën e gjuhës në vijim si: „Start

Deutsch 1“ të institutit Goete ose të telc GmbH, „Grundstufe Deutsch 1“ të diplomës së gjuhës nga Austria (ÖSD), „Test-DaF“ të institutit TestDaF sh.r.

Ju lutemi keni parasysh, që njohurit tuaja të gjuhës veçanërisht evidentohen nga ana e emisioneve diplomatike gjermane, në momentin kur ju të aplikoni për vizë.

Në qoftë se gjatë paraqitjes suaj personale në ambasadë ose në konsullatën e përgjithshme del se i keni njohuritë e kërkuara të thjeshta të gjermanishtes pa asnjë dyshim, nuk keni nevojë për dëshmi të veçantë.

Informacione për atë se si duhet t'i provoni njohuritë e thjeshta të Gjermanisë i gjeni edhe në webfaqet e zyrave të vizave të ambasadave gjermane dhe konsullatave të përgjithshme. Ato ju këshillojnë në rastin individual për kërkesën e vizës.

Si mund të fitoni njohuri të thjeshta të gjermanishtes?

Në qoftë se ende nuk keni njohuri të thjeshta të gjermanishtes, ka mundësi të ndryshme për ta mësuar gjuhën gjermane:

Kurse gjuhe të të gjithë ofruesve

Informacione për ofruesit e kurseve të gjuhëve i gjeni në përfaqësinë e jashtme të Gjermanisë dhe në Institutin Goethe.

Mësimi i gjuhës në kurse me korrespondencë të Institutit Goethe ose nëpërmjet internetit

Materialin e plotë të ushtrimit për provimin, me të cilin mund të përgatiteni vetë për testin e gjuhës "Starti i gjermanishtes 1", si dhe informacione për kurse me korrespondencë i gjeni në webfaqen e Institutit Goethe. Atje ka edhe ushtrime të tjera për nivelin A1. Informacione të tjera ka në webfaqen si dhe në numrin e telefonit **+49 911 - 943 6390** të Entit Federal për Migrim dhe Refugjatë.

¹ Kr. § 28 kryerr. 1 fjali 5 dhe § 30 kryerr. 1 fjali 1 nr. 2 si dhe përjashtimet në § 30 kryerr. 1 fjali 2 dhe 3 të ligjit gjerman të qëndrimit si dhe § 41 i urdhërësës së qëndrimit.

² Kornizë referimi për të cilën kanë rënë dakord shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës.